



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
NJOFTIM

PËR PUNËSIMIN E PUNONJËSVE ME KOHË JO TË PLOTË PUNE PËR HAPJEN E KUTIVE TË VOTIMIT TË PËRDORURA PËR ZGJEDHJET E KUVENDIT TË VITIT 2021

Bazuar në neni 19, të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimin nr.109, datë 06.03.2019, të Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e standardeve në kryerjen e disa aktiviteteve me punonjës të përkohshëm, në njësitë e qeverisjes qendrore”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në përmbushje të detyrimit për administrimin e zgjedhjeve do të rekrutojë punonjës me kohë jo të plotë pune.

- Pozicione pune.
 - specialist;
 - operatorë;
 - punëtor logjistike.
- Pozicione pune, periudha dhe kategoria e pagës.

| Strukturë organika | Pozicione pune | Numri i punonjësve | Periudha e Punësimit | Kategoria e Pagës | Kriteret e punësimit |
|--------------------|----------------|--------------------|----------------------|-------------------|----------------------|
|--------------------|----------------|--------------------|----------------------|-------------------|----------------------|

Drejtoria Komisioneve dhe Materialeve Zgjedhore

| | | | | | |
|---------------------------------|------------|----|--------|------|---|
| Sektori i Materialeve Zgjedhore | Specialist | 13 | 2 muaj | IV-b | Arsim i lartë/të ketë eksperiencë pune në logjistikën zgjedhore |
| | Specialist | 2 | 3 muaj | | |
| | Punëtor | 45 | 2 muaj | III | Arsim i detyruar |

Drejtoria e Burimeve Njerëzore

| | | | | | |
|--|----------|---|--------|---|------------------|
| Sektori i Administrimit dhe Arkivimit të Dokumentacionit | Operator | 5 | 2 muaj | V | Arsim i detyruar |
|--|----------|---|--------|---|------------------|

PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I PUNËS (DETYRAT KRYESORE)

| STRUKTURA/DREJTORIA | DETYRAT FUNKSIONALE |
|--|---|
| DREJTORIE KOMISIONEVE DHE MATERIALEVE ZGJEDHORE | të mbikëqyrin procesin e hapjes së kutive në bazë qarku dhe sipas ndarjes së KZAZ-ve për secilin qark; të evidentojnë dokumentacionin zgjedhor dhe të plotësojnë procesverbalin për secilën KZAZ, sipas modelit që miratohet me vendim të Komisioneri Shtetëror të Zgjedhjeve. |
| PUNONJËS MBËSHTETËS | të krijojnë infrastrukturën e nevojshme për hapjen e kutive; të seleksionojnë dokumentacionin zgjedhor si; listën e zgjedhësve, libri i protokollit të mbledhjeve, procesverbali i konstatimit të përdorura nga KQV-ja; të ndajnë materialet zgjedhore të ripërdorshme; pastrimin e kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore |

**DREJTORIA E BURIMEVE
NJERËZORE**

të kryejnë përpunimin tekniko-shkencor (numërtim, përshkrim dosje, sistemin nëpër kuti) sipas ligjit për Arkivat, për dokumentacionin që do të administrohet (lista e zgjedhësve, libri i protokollit të mbledhjeve, procesverbali i konstatimit, procesverbali i hapjes dhe mbylljes së kutive), i cili në zbatim të Kodit Zgjedhor do të dërgohet në Arkivën Qendrore të Shtetit.

KRITERE PUNËSIMI PËR SPECIALIST

- Të kenë arsim të lartë bachelor/master/profesional/shkencor në degët e mëposhtme;
- juridik, ekonomik.
- Të kenë jo më pak se dy vjet eksperiencë pune në administratën dhe në fushën e zgjedhjeve.
- Të ketë aftësi bashkëpunimi dhe bashkëveprimi.
- Të kenë aftësi të mira komunikimi, për të punuar në grup, me orare të zgjatura.
- Të përdorë lehtësisht programet bazë kompjuterike.
- Të japë maksimumin në punë me orare të zgjatura.

KRITERE PUNËSIMI PËR OPERATORË

- Të arsim të detyruar preferohet arsim të lartë/ bachelor.
- Të kenë jo më pak se dy vjet eksperiencë pune në administratën dhe në fushën e zgjedhjeve.
- Të ketë aftësi bashkëpunimi dhe bashkëveprimi.
- Të kenë aftësi të mira komunikimi, për të punuar në grup, me orare të zgjatura.
- Të përdorë lehtësisht programet bazë kompjuterike.
- Të japë maksimumin në punë me orare të zgjatura.

KRITERE PUNËSIMI PËR PUNËTORË

- Të kenë arsim të detyruar.
- Të kenë jo më pak se dy vjet eksperiencë pune në administratën dhe në fushën e zgjedhjeve.
- Të ketë aftësi bashkëpunimi dhe bashkëveprimi.
- Të kenë aftësi të mira komunikimi, për të punuar në grup, me orare të zgjatura.
- Të përdorë lehtësisht programet bazë kompjuterike.
- Të japë maksimumin në punë me orare të zgjatura.

AFATI PËR DORËZIMIN E DOKUMENTEVE:

31.01.2022

MËNYRA E APLIKIMIT PËR DORËZIMIN E DOKUMENTACIONIN DO TË JETË

 Online, në faqen zyrtare elektronike të KQZ-së, në linkun:

 [Apliko](#)

 Pranë institucionit të KQZ-së, në adresën: Rruga “Ibrahim Rugova”, Nr.04, Tiranë.

 Me anë të postës zyrtare në adresën: Rruga “Ibrahim Rugova”, Nr.04, Tiranë.